



Npi – 01/210 datë: 29.09.2020

Kuvendi i Komunës së Shtimes, diskutoi për Propozim-Vendimin e Zyrës së Kryetarit Nr.02/478, datë: 22.09.2020, dhe duke u bazuar në nenin 17 pika (a) dhe (c), dhe nenin 58 pika (h) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040; Nenin 6 paragrafi 1.2, neni 8 paragrafi 1.2 dhe neni 14 paragrafi 1, 2 dhe 3 të Ligjit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës Nr.06/L-092, nenit 8 të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 Për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës Kuvendi i Komunës së Shtimes, mori këtë:

V E N D I M

PËR SHPALLJE ME INTERES TË PËRGJITHSHËM PRONËN E PA LUAJTSHME TË KOMUNËS SË SHTIMES

I

Kuvendi i Komunës së Shtimes në mbledhjen e -VII- të rregullt për vitin 2020, të mbajtur më: 29.09.2020, me shumicën e votave aprovoi, vendimin për shpallje me interes të përgjithshëm, për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër, për 15 vite, pronën e paluajtshme Komunale:

1. Prona e pa luajtshme e Komunës të Vendi i quajtur “Gështenja”, Ngastra Kadastrale: Nr. P-72809093-02270-4; Me sipërfaqe 33220m²; Zona Kadastrale – Shtime; Kultura – Kullosë e klasit të 3; Evidentuar, “Pasuri shoqërore e Kuvendit Komunal-Shtime”. Periudha kohore e dhënies në shfrytëzim 15 vite.

II

A r s y e t i m: Qëllimi i dhënies në shfrytëzim afatshkurtër, të pronave të paluajtshme të Komunës së Shtimes është: Të mundësoj implementimin e planeve komunale siq janë Realizimin e Planit Zhvillimor Komunal 2009 – 2020, Përkrahja e bizneseve vendore. Do të ndikojë pozitivisht në Punësim, Investime, Shtimin e numrit të bizneseve, Rritje e numrit të taksapaguesve, Zhvillim ekonomik, dhe të hyra për Komunën.

III

Procedura për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatshkurtër, do të kryhet duke u bazuar në ligjet pozitive si dhe përmes Ankandit Publik.

IV

Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë nga dita e rexhistrimit në evidencën e protokolit zyrtar në MAPL, si dhe publikimi në Ueb – faqen zyrtare të Komunës së Shtimes.

V

Vendimi u dërgohet: Arkivit, Drejtorive, Kryetarit të Komunës, Zyrës për Informim. dhe Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal.



Kryesuesja e Kuvendit
Medina Brahaj